

# RAPORT MONITORIMI 6-MUJOR I ZBATIMIT TË BUXHETIT VJETOR



Bashkia Kukës



JANAR - QERSHOR 2024

Ky raport monitorimi është përgatitur në kuadër të projektit “Qytetarët të parët: Bashkë për një qeverisje vendore transparente!”, zbatuar nga shoqata “Together for Life”, me mbështetje nga skema e granteve “BAT-Shoqëria Civile”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në partneritet me Qendrën për Kërkim dhe Politikë-bërje (QKPM) dhe Faktoje, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

*Autor: © TOGETHER FOR LIFE  
Rr. Brigada VIII, Tiranë, Shqipëri  
Email: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)  
Web: [www.togetherforlife.org.al](http://www.togetherforlife.org.al)*

# TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje.....	4
2. Metodologjia e përgatitjes së raportit .....	5
3. Të dhënat dhe kufizimet .....	6
4. Buxheti i Bashkisë Kukës për vitin 2024.....	6
• 4.1 Cilësia e planifikimit buxhetor.....	10
• 4.2 Transparenca.....	12
• 4.3 Planifikimi i investimeve.....	13
5. Performanca Financiare dhe Jo Financiare e Bashkisë Kukës Janar -Qershor 2024.....	14
• 5.1 Performanca e të ardhurave të bashkisë.....	14
• 5.2 Performanca e shpenzimeve.....	16
• 5.2.1 Performanca e shpenzimeve për programet buxhetore.....	18
• 5.2.2 Niveli i realizimit të projekteve të investimeve publike.....	21
• 5.2.3 Performanca e projekteve.....	24
• 5.2.3.1 Performanca financiare.....	24
• 5.2.3.2 Performanca jo-financiare.....	25
6. Konkluzione dhe Rekomandime.....	26
7. Referenca.....	28

## LISTA E TABELAVE:

Tabela 1: Buxheti 2024 sipas Programeve Buxhetore për Bashkinë Kukës.....	08
Tabela 2: Buxheti i Bashkisë Kukës për vitin 2024 sipas burimeve të financimit në 000/lekë.....	10
Tabela 3: Buxheti i Bashkisë Kukës sipas natyrës së shpenzimeve. ....	11
Tabela 4: Projektet e investimeve publike të planifikuara për Bashkinë Kukës 2024-2026 në 000/lekë. ....	13
Tabela 5: Realizimi i të ardhurave të veta të Bashkisë Kukës 6-mujori i parë 2024.....	15
Tabela 6: Realizimi 6 mujor i buxhetit të Bashkisë Kukës sipas programeve buxhetore në 000/lekë. ....	16
Tabela 7: Plani dhe Fakti i shpenzimeve për projektet e investimeve publike. ....	21

## LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1 : SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE PUBLIKE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE.....	23
---	----

# HYRJE

Shoqata “Together for Life”, në kuadër të projektit [“Qytetarët të parët: Bashkë për një qeverisje vendore transparente!”](#), me mbështetje nga skema e granteve “BAT-Shoqëria Civile”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në partneritet me Qendrën për Kërkim dhe Politikë-bërje (QKPM) dhe Faktoje, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian, përgatit [“Raportin e Monitorimit 6 mujor të zbatimit të buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës”](#) duke kontribuar në përmirësimin e transparencës buxhetore të kësaj bashkie në përputhje me detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor ekzistues.

Raporti i Monitorimit analizon shpenzimet e kryera (faktike) nga Bashkia Kukës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 (Janar – Qershor), sipas zërave të shpenzimeve dhe produkteve/projekteve të investimeve publike krahasuar me planifikimin fillestar të buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak për vitin 2024. Më tej, raporti shqyrton arritjet e Bashkisë Kukës në drejtim të realizimit të objektivave të përcaktuara në buxhetin 2024, nën lupën e transparencës dhe llogaridhënies së këtyre rezultateve ndaj të gjithë palëve të interesuara, ku një vend të veçantë kanë qytetarët e kësaj bashkie dhe nevojat e tyre.

Raporti është i strukturuar në katër pjesë kryesore.

Në pjesën e parë të raportit jepet një hyrje e përgjithshme e fokusit të raportit të monitorimit, metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit si edhe kufizimet në analizën e të dhënave.

Në pjesën e dytë të raportit bëhet një përshkrim i detajuar i prioriteteve kryesore të buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2024, duke ndaluar në cilësinë e planifikimit buxhetor dhe planifikimin e investimeve.

Ndërkohë në pjesën e tretë përshkruhet performanca financiare dhe jo financiare e Bashkisë Kukës për periudhën e kryerjes së monitorimit (Janar – Qershor 2024).

Në pjesën e katërt paraqiten gjetjet kryesore të monitorimit si edhe disa rekomandime për Bashkinë Kukës sesi mund të përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënien për qytetarët e saj.

## 2. METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË RAPORTIT

Përgatitja e këtij raporti monitorimi është realizuar përmes një qasje analitike dhe krahasuese të të dhënave të publikuara nga Bashkia Kukës dhe Ministria e Financave përgjegjëse për fazën e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Të dhënat e përdorura për analizë janë sasiore dhe cilësore. Raporti i monitorimit është përgatitur gjatë periudhës Qershor – Shtator 2024 dhe metodat e përdorura për përgatitjen e tij janë:

Rishikimi i Dokumenteve: Janë shqyrtuar dokumentet e publikuara nga Bashkia Kukës në fushën e dytë të programit të transparencës: Transparenca dhe Llogaridhënia ekonomike – financiare. Janë konsultuar konkretisht këto dokumenta: kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor; paketa fiskale (taksa dhe tarifa); plani strategji i Zhvillimi të bashkisë/ programi buxhetor afatmesëm vendore, buxheti i Bashkisë Kukës 2024, Monitorimi dhe Mbikqyrje e buxhetit; donacione etj.

Analiza Krahasuese: Performanca financiare e Bashkisë është krahasuar me buxhetin e miratuar, duke identifikuar devijimet dhe analizuar arsyet e mundshme të tyre. Kjo analizë është bërë në përputhje në standardet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe atë për financat e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë të mirëpërcaktuar procedurat dhe përmbajtjen që duhet të kenë dokumenta të rëndësishëm të prodhuar nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në çdo fazë të përgatitjes së buxhetit.

Vlerësimi i Cilësisë: Cilësia e dokumenteve të buxhetit dhe raporteve të monitorimit është vlerësuar sipas kritereve të përcaktuara në legjislacion, për të siguruar që dokumentet përmbushin standardet e nevojshme.

Raporti është strukturuar në katër pjesë kryesore, për të siguruar një qasje sistematike dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Në përfundim të raportit, janë propozuar rekomandime konkrete për Bashkinë Kukës për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve, përmirësimin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si edhe të sigurojë një menaxhim sa më efektiv të burimeve financiare të Bashkisë.

### **3. TË DHËNAT DHE PËRKUFIZIMET**

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë marrë nga faqja zyrtare e Bashkisë Kukës si dhe nga faqja zyrtare e Ministrisë së Financave.

[Në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës, vihet re që ka një organizim të strukturuar mjaft mirë të informacionit që lidhet me procesin e buxhetimit dhe konsultimit publik të tij.](#) Të gjitha dokumentat dhe raportet e lidhura me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm për vitet 2024-2026, Buxheti i miratuar për vitin 2024 dhe Raportet e monitorimit në vite rezultojnë të publikuara dhe plotësisht të aksesueshme për të përgatitur raportin.

Për shkak se të dhënat e publikuara nga këto institucione janë me bazë 4-mujore (për shkak të parashikimeve ligjore të monitorimit mbi këtë frekuencë raportimi), të dhënat e realizimit faktik 6 mujor janë kërkuar dhe në mënyrë shkresore drejtuar Bashkisë Kukës. Bashkia Kukës i është përgjigjur kërkesës sonë menjëherë dhe me korrektësi duke raportuar mbi të dhënat financiare të periudhës sipas kërkesës sonë.

Ndërkohë në drejtim të cilësisë së të dhënave të publikuara dhe të raportuara vlerësojmë se ka ende vend për përmirësim të mëtejshëm. Theksojmë që mungesa e të dhënave cilësore ka shërbyer si kufizim në analizën e performancës së shpenzimeve dhe produkteve të realizuara në këtë bashki gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024.

### **4. BUXHETI I BASHKISË KUKËS PËR VITIN 2024**

Bashkia Kukës përbëhet nga 15 Njësi administrative: Qyteti Kukës - qendra e Bashkisë dhe 14 njësitë administrative Malzi, Bicaçaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën, Kolsh.

Në zbatim të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, buxheti i çdo Njësie të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) përbëhet nga tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë të cilat miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e krijuara nga NJVV grupohen në tre grupe kryesore të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara dhe të ardhurat nga tarifat vendore.

Krahas të ardhurave të veta, NJVV financohen dhe nga buxheti qendror në formën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe në formën e transfertës së kushtëzuar dhe asaj specifike. Në menaxhimin financave vendore, njësitet e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat, procesi i planifikimit buxhetor, zbatimit dhe monitorimit të tij ndjek të njëjtat procedura që ndjek procesi i miratimit të buxhetit në nivel qendror.

Në këtë kuptim, miratimi i buxhetit për NJVV bëhet mbështetur në dokumentin buxhetor afatmesëm respektiv, në të cilin përcaktohen objektivat e NJVV për periudhën afatmesme, produktet dhe treguesit e performancës në nivel programi buxhetor.

Konkretisht, referuar Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit të miratuar për vitin 2024, fokusi i Bashkisë Kukës parashikohet të jetë në përmirësimin e shërbimeve publike, në mbajtjen pastër të hapësirave, në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, në rritjen e sigurisë së jetës dhe aktivitetit ekonomik të banorëve, në ndriçimin e rrugëve dhe ambienteve publike, në rritjen e kujdesit dhe shërbimet për familjen, për personat me aftësi ndryshe, për gratë të moshuarit duke përmirësuar dhe rritur sigurinë e jetës të banorëve.

Për të realizuar këtë qëllim, Bashkia Kukës financohet nga dy burime kryesore: (i) të ardhurat e veta; dhe (ii) mbështetja nga buxheti qendror në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe asaj specifike. Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Kukës, referuar programeve kryesore të shpenzimeve, është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.66, datë 22.12.2023, dhe Buxheti 2024 është miratuar me Vendimin e Këshillit nr.65, datë 22.12.2023.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet sipas programeve buxhetore, buxheti i bashkisë Kukës për vitin 2024 në mijë lekë.

Tabela 1: Buxheti 2024 sipas programeve buxhetore për Bashkinë Kukës

<b>Programi buxhetor</b>	<b>Emërtesa</b>	<b>Buxheti afatmesëm 2024</b>	<b>Buxheti 2024</b>	<b>Pesha e programit në % ndaj totalit</b>
01110	Administrim Planifikim	<b>260,968</b>	<b>260,968</b>	<b>16%</b>
01170	Gjendja civile			<b>0%</b>
03140	Sherbimet e policise vendore	<b>26,040</b>	<b>26,040</b>	<b>2%</b>
03280	Emergjenca civile	<b>62,669</b>	<b>62,669</b>	<b>4%</b>
04220	Shërbimet bujqesore	<b>11,770</b>	<b>11,770</b>	<b>1%</b>
04240	Ujitja dhe Kullimi	<b>7,025</b>	<b>7,025</b>	<b>0%</b>
04260	Shërbimi Pyjor	<b>13,535</b>	<b>13,535</b>	<b>1%</b>
04520	Rrugët rurale	<b>34,516</b>	<b>34,516</b>	<b>2%</b>
04960	Fond Rezerve /Kontigjence	<b>3,985</b>	<b>3,985</b>	<b>0%</b>
05100	Menagjim i mbetjeve	<b>15,241</b>	<b>15,241</b>	<b>1%</b>
06140	Planifikimi Urban Vendor	<b>12,424</b>	<b>12,424</b>	<b>1%</b>
06260	Sherbimet Komunitare	<b>281,423</b>	<b>281,423</b>	<b>17%</b>
06370	Projekte UKK			<b>0%</b>
8130	Sporti	<b>5,603</b>	<b>5,603</b>	<b>0%</b>
08220	Trashegimia kulturore dhe aktivitete artistike	<b>18,220</b>	<b>18,220</b>	<b>1%</b>
09120	Arsimi parashkollor	<b>149,110</b>	<b>149,110</b>	<b>9%</b>
09230	Konvikti dhe Arsimi i Mesem	<b>26,862</b>	<b>26,862</b>	<b>2%</b>
10430	Kujdersi Social	<b>335,712</b>	<b>335,712</b>	<b>21%</b>
10910	Emergjencat civile Qendrori			<b>0%</b>
10661	Strehimi Social	<b>347,318</b>	<b>347,318</b>	<b>22%</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>1,612,451</b>	<b>1,612,451</b>	<b>100%</b>

Buxheti total i Bashkisë Kukës rezulton i planifikuar në masën 1.612 miliardë lekë dhe parashikohet të shpenzohet kryesisht për: (i) pagesat sociale si strehimi social, ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë në masën 22%; (ii) për shërbimet komunitare në masën 17%; dhe (iii) për shpenzime administrative të bashkisë në masën 16%.

Sipas burimeve të financimit, Buxheti i Bashkisë Kukës për vitin 2024 planifikon të financojë prioritetet e politikave me 13% të totalit nga të ardhurat e veta (përfshirë të ardhurat e trashëguara) dhe 87% nga buxheti qendror. Sikurse kuptohet nga kjo shpërndarja burimet e veta të Bashkisë Kukës rezultojnë të kufizuara me mesatarisht 9% (referoju Tabelës 2 më poshtë), ndërkohë që varësia nga buxheti qendror rezulton jetike për të mundësuar që të përmbushen funksionet bazë dhe ato të deleguara të pushteti qendror. Referuar Raportit 2023 – Financat Publike Vendore[1], publikuar nga Ministria e Financave, Bashkia Kukës renditet ndër Bashkitë me rënien më të madhe të ardhurave krahas bashkisë Belsh, Skrapar dhe Memaliaj (mbi 20% rënie).

Sipas të njëjtit raport, 9 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2023 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2022. Ndër bashkitë me rënien më të madhe të shpenzimeve janë renditur bashkitë Kukës, Roskovec dhe Konispol, me rënie 10 -11% në krahasim me një vit më parë. Në këtë raport, si dhe në dokumentat buxhetor të Bashkisë Kukës mungojnë analizat mbi shkaqet e kësaj performance dhe masat e marra për përmirësimin e saj.



Tabela 2: Buxheti i Bashkisë Kukës për vitin 2024 sipas burimeve të financimit në 000/lekë

Burimet financiare	Buxheti2024	Pesha e zërave ndaj totalit
Të ardhura nga burimet e veta	146,582	9%
Të ardhurat nga taksat lokale	61,908	4%
Të ardhura nga taksat e ndara	10,331	1%
Të ardhurat nga tarifa vendore	68,441	4%
Të ardhura të tjera	5,902	0%
Të ardhura nga buxheti qendror	1,396,902	87%
Transferta e pakushtëzuar	428,363	27%
Fonde të kushtëzuara	666,068	41%
Transferta specifike	302,471	19%
Të trashëguara nga viti paraardhës	68,967	4%
Totali i burimeve	1,612,451	

\*Fondet e kushtëzuara janë fondet që alokon buxheti qendror për bashkinë Kukës për të mundësuar pagesën e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, që është funksion i buxhetit qendror.

## 4.1. CILËSIA E PLANIFIKIMIT BUXHETOR

Sipas zërave kryesorë të shpenzimeve, buxheti i Bashkisë Kukës për vitin 2024 planifikohet si vijon:

[1] <https://core.fvv.al/storage/reports/analiza-e-financave-vendore-2023-finalpdf-1721811582.pdf>

Tabela 3 : Buxheti i Bashkisë Kukës sipas natyrës së shpenzimeve

	<b>Buxheti2024</b>	<b>Pesha e zërave ndaj totalit</b>
Shpenzime personeli	551,662	<b>34%</b>
Të tjera korrente	903,158	<b>56%</b>
Shpenzime kapitale	157,631	<b>10%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1,612,451</b>	<b>100%</b>

Referuar natyrës së shpenzimeve buxheti i Bashkisë Kukës planifikohet të shpenzohet si vijon:

- 56% për shpenzime operative, mirëmbajtje, pagesa sociale dhe shërbime të ndryshme;
- 34% për paga dhe sigurime shoqërore për administratën e bashkisë dhe njësive administrative;
- dhe vetëm 10% e këtij buxheti i dedikohet investimeve publike të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

Nëse do t'i referohemi dokumentit të PBA të Bashkisë Kukës, i cili përbën dhe një dokument politikash dhe prioritetesh, vërejmë që 4 janë objektivat primarë mbi bazën e të cilit mbështetet dhe planifikimi buxhetor afatmesëm e konkretisht:

1. Një cilësi më e mirë banimi në territorin e Kukësit;
2. Akses më i mirë në zonën e brendshme të Kukësit dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndër-kufitare;
3. Shfrytëzim i qëndrueshëm i burimeve mjedisore si në aspektin e turizmit ashtu dhe të energjisë dhe minierave;
4. Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit lokal.

Pavarësisht se objektivat e vendosur në dokumentin buxhetor afatmesëm rezultojnë të formuluar mirë dhe adresojnë nevojat dhe problematikat e bashkisë Kukës, është e vështirë të gjesh më tej në dokumentin buxhetor afatmesëm produkte konkrete për çdo program buxhetor dhe tregues performance të matshëm për të vlerësuar se si këto objektiva do të arrihen përmes buxhetit të planifikuar për vitin 2024.

Cilësia e planifikimit buxhetor afatmesëm të Bashkisë Kukës rezulton e dobët dhe jo në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore të fushës së menaxhimit të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

## **4.2 TRANSPARENCA**

Kjo cilësi e dobët përkthehet në mungesë informacioni dhe transparence për qytetarët e Bashkisë Kukës mbi eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike në drejtim të adresimit të nevojave dhe prioriteteve të zonës. Informacioni i disponueshëm për çdo program buxhetor është i mbështetur në shpenzime dhe shumë pak në produkte. Dhe, në rastet kur është bërë përpjekje për të identifikuar produkte, ato në realitet përfaqësojnë shpenzime sipas natyrës ekonomike dhe jo rezultate konkrete të pritshme.

Për çdo funksion ka informacion financiar mbi shpenzimet e planifikuara për të përballuar pagat e administratës dhe shpenzimet operative apo kapitale të planifikuara për të. Por nuk ka informacion mbi produktet konkrete të programit.

Konkretisht po ilustruam me një shembull rastin e funksionit “Arsimi” dhe programin respektiv buxhetor “Arsimi parashkollor”, ku ka informacion vetëm për shpenzimet e personelit dhe të tjera korrente të lidhur me këtë program. Përveç statistikave të numrit të fëmijëve të zonës dhe numrit të kopshteve që paraqiten në fund të dokumentit (të palidhura me deklaratën e politikës së programit apo buxhetin respektiv të planifikuar për të), mungon një analizë e rezultateve të programit (i) mbi ofrimin e shërbimit arsimor, (ii) problematikat e ndryshme që hasin mësuesit apo fëmijët, (iii) analiza të projekteve të investimeve dhe se si rikonstruksionet e çerdheve apo kopshteve do të mund (iv) të adresojnë nevojat e prindërve të zonës etj.

## 4.3 PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE

Sa i përket investimeve publike të planifikuara për t'u realizuar për vitin 2024, projektet e parashikuara janë ndarë në projektet në vazhdim dhe projekte të reja.

Tabela 4 :Projektet e investimeve publike te planifikuara për Bashkinë Kukës 2024-2026 në 000/lekë

Planifikimi i investimeve për bashkinë Kukës	PBA 2024	PBA 2025	PBA 2026
Projekte në vazhdim	<b>80,904</b>	<b>27,565</b>	<b>10,000</b>
Bashkëfinancime	5,000	5,000	5,000
Hartim projektesh	5,000	5,000	5,000
Blerje mjetesh për mirëmbajta rrugësh	10, 752		
Sistemim asfaltim rruge fshati Nange	7,214		
Asfaltim i rrugës Kolsh	11,951		
Ndërtim rruge qender Shtiqen-aeroport	18,996		
Asfaltim i rrugës Kalimash, njësia Malzi	7,689	7,689	
Rehabilitimi i qendrës, lagje Gostil, loti 1	9,000	9,876	
Rehabilitimi i shkollës së mesme Bairam Avdiu-Canai, Niësia Bicaj	5,302		
<b>Projekte të reja</b>	<b>76,727</b>	<b>133,219</b>	<b>133,820</b>
Asfaltimi curëve të brendshme, lagjia e re Kukës	28,000	31,000	31,000
Rikonstruksion i urës Topojan	10,000	6,250	6,250
Rikonstruksion i rrugës Myc-Mames-Surroj	17,461	95,969	96,570
Blerje automjeti për nevoja të Bashkisë Kukës	4200		
Blerje pajisjesh kompjuterike	1,200		
Studim kerkim uji i pijshëm	2,500		
Studim projektim rikonstruksion i rrugës hyrëse Ura e Drinit të Zi-Radio Kukësi	8,400		
Studim projektim asfaltim i rrugeve lagje e re Kukës	2,700		
Studim projektim i rrugës Topojan	675		
Studim projektim i cerdhes nr1, lagjia nr.1	1,141		
Studim projektim rrjeti ujesjelles kanalizim fshati Breg -Lume	450		
<b>Totali</b>	<b>157,631</b>	<b>160,784</b>	<b>143,820</b>

*Plani i investimeve për vitin 2024 parashikohet në nivelin prej 157.6 milionë lekë nga të cilat 80.9 milionë lekë parashikohen për projektet në vazhdim dhe 76.7 milionë lekë për projekte të reja. Nga një vështrim i hollësishëm i dokumentit të PBA të Bashkisë Kukës dhe dokumentit të Buxhetit 2024 kuptohet se, përveç emrit të projektit, është e vështirë të analizosh se si është bërë prioritarizimi i tyre dhe për pasojë zgjedhja për financim për vitin në fjalë. Mungojnë informacione në terma përfituesish dhe analiza cilësore për të lidhur nevojat e shprehura në takimet konsultative të buxhetit të qytetarëve të bashkisë Kukës me adresimin e tyre konkret në buxhet.*

Në përfundim, vlerësojmë se hallka e planifikimit buxhetor në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve publike për Bashkinë Kukës rezulton të jetë më së shumti një ushtrim teorik, jo-konkret dhe me transparencë të ulët. Kjo e bën të vështirë të kuptuarit se sa realisht ky buxhet plotëson nevojat e qytetit dhe njësive administrative, si prioritarizohen shpenzimet dhe projektet për të realizuar një shërbim cilësor për qytetarin dhe cilat janë problematikat e mundshme të zonës, të cilat duhet të jenë në vëmendje të qeverisë vendore dhe qendrore si dhe të të gjitha palëve të interesuara.

## **5. PERFORMANCA FINANCIARE DHE JO FINANCIARE E BASHKISË KUKËS PËR 6-MUJORIN E VITIN 2024**

### **5.1 Performanca e të ardhurave të bashkisë**

Monitorimi i buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet mbështetur në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr.9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Sipas këtyre akteve, NJVV duhet të përgatisin raporte periodike dhe vjetore monitorimi.

Këto raporte duhet të përmbajnë informacione mbi performancën e shpenzimeve dhe produkteve të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve në varësi të tyre. Sipas udhëzimit nr.22/2018, monitorimi i objektivave kryhet bazuar në treguesit përkatës të performancës që jepen kryesisht në nivel produkti, ndërsa monitorimi i produkteve realizohet në sasi dhe vlerë. Raportet e monitorimit përgatiten me frekuencë 4-mujore dhe duhet të përmbajnë:

- ➡ Të dhëna në lidhje me performancën e objektivave;
- ➡ Të dhëna në lidhje me performancën e çdo produkti;
- ➡ Analizën që shpjegon mospërputhjet e rëndësishme në lidhje me planin e periudhës;
- ➡ Përmbledhje e përditësuar e shpenzimeve dhe realizimit të produkteve;
- ➡ Të tjera çështje.

Në kushtet kur raporti i parë i monitorimit për vitin 2024 i publikuar nga Bashkia Kukës është për 4-mujorin e parë të vitit, të dhënat e publikuara për të mundësuar një analizë të hollësishme të rezultateve të punës së Bashkisë Kukës rezultojnë të kufizuara. Mbështetur në raportimin e të dhënave nga Bashkia Kukës më poshtë po paraqesim realizimin faktik të të ardhurave të veta të bashkisë për 6 mujorin e parë 2024 sipas zërave kryesorë:

Tabela 5: Realizimi i të ardhurave të veta të Bashkisë Kukës 6-mujori i parë 2024

Burimet financiare	Buxheti2024	Pesha e zërave ndaj totalit	Realizimi 6 mujor 2024	Realizimi në % ndaj planit
Të ardhura nga burimet e veta	146,582	9%	144,034	98%
Të ardhurat nga taksat lokale	61,908	4%	47,739	77%
Të ardhura nga taksat e ndara	10,331	1%	33,104	320%
Të ardhurat nga tarifa vendore	68,441	4%	62,803	92%
Të ardhura të tjera	5,902	0%	387	7%

Sikurse shihet realizimi i të ardhurave për 6 mujorin e parë 2024 është në nivelin 98%, duke tejkaluar parashikimet e bëra për 6 mujorin. Performancë të lartë shfaqin të ardhurat nga taksat lokale ku përfshihen taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, renta minerare dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Sërish bie në sy cilësia e ulët e planifikimit të të ardhurave, qoftë sipas zërave të cilat shfaqin devijanca të dukshme nga planifikimi fillestar, po ashtu edhe totali i të ardhurave, të cilat kanë tejkaluar nivelin e pritshëm që në 6 mujorin e parë të vitit. Në dokumentat zyrtarë të publikuar nga Bashkia Kukës lidhur me monitorimin e situatës së të ardhurave nuk gjejmë analiza mbi performancën e të ardhurave dhe cilat janë pritshmëritë deri në fund të vitit.

## 5.2 Performanca e shpenzimeve

Ndërkohë performanca e shpenzimeve sipas programeve kryesore buxhetore (këtu përfshihen të ardhurat e veta, si dhe financimet nga buxheti qendror) rezulton si më poshtë vijon:

Tabela 6 : Realizimi 6 mujor i buxhetit të Bashkisë Kukës sipas programeve buxhetore në 000/lekë

Programi buxhetor	Emertesa	Programi Buxhetor Afatmesem 2024	Buxheti 2024	Pesha e programit në % ndaj totalit	Buxheti progresiv 2024	Fakti 6 mujor	Përqindja e realizimit
01110	Administrim Planifikim	260,968	260,968	16%	374,115	134,839	36%
01170	Gjendja Civile			0%	13,363	6,014	45%
03140	Sherbimet e policise vendore	26,040	26,040	2%			0%

Programi buxhetor	Emertesa	Programi Buxhetor Afatmesem 2024	Buxheti 2024	Pesha e programit në % ndaj totalit	Buxheti progresiv 2024	Fakti 6 mujor	Përqindja e realizimit
03280	Emergjenca civile	62,699	62,699	4%	87,806	22,214	25%
04220	Sherbimet Bujqesore	11,770	11,770	1%			0%
04240	Ujitja dhe Kullimi	7,025	7,025	0%	14,691	493	3%
04260	Sherbimi Pyjor	13,535	13,535	1%	22,998	9,754	42%
04520	Rruget Rurale	34,516	34,516	2%	32,431	9840	30%
04960	Fond Rezerve/Kontigjence	3,985	3,985	0%	7,801	2,068	27%
05100	Menaxhimi I Mbetjeve	15,241	15,241	1%			0%
06140	Planifikimi Urban Vendor	12,424	12,424	1%			0%
06260	Sherbimet komunitare	281,423	281,423	17%	257,274	182,755	71%
06370	Projekte UKK			0%	20,207	0	0%
08130	Sporti	5,603	5,603	0%	3,500	3,000	86%
08220	Trashegimia kulturore dhe aktivitetet artistike	18,220	18,220	1%			0%
09120	Arsimi parashkollor	149,110	149,110	9%	199,958	71,370	36%
09230	Konvikti dhe Arsim i Mesëm	26,862	26,862	2%	80,946	14,228	18%
10430	Kujdesi Social	335,712	335,712	21%	549.188	361,591	66%
10910	Emergjencat Civile Qendrori			0%	10,586	0	0%
10661	Strehimi Social	347,318	347,318	22%	0	0	0%
	<b>Totali</b>	<b>1,612,451</b>	<b>1,612,451</b>	<b>100%</b>	<b>1,674,864</b>	<b>818,167</b>	<b>49%</b>

Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve rezulton në nivelin 49% krahasuar me buxhetin me ndryshime 2024, realizim që konsiderohet normal për periudhën. Por ajo që vihet re nga krahasimi i të dhënave zyrtare është që buxheti me ndryshime rezulton në masën 1.674 miliardë lekë nga 1.612 miliardë të miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak, pra 62.4 milionë lekë diferencë. Lidhur me këtë diferencë nuk gjejmë shpjegime në të dhënat zyrtare të raportuara nga Bashkia Kukës. Përveç diferencës totale të buxhetit fillestar dhe atij me ndryshime, ajo që bie në sy është devijanca mes shpenzimeve të planifikuara në nivel programi buxhetor në buxhetin fillestar dhe planit të raportuar nga Bashkia Kukës për periudhën. Vihet re që disa programe buxhetore për të cilat ka pasur plan fillestar buxheti si:

»» “Shërbimet e policisë vendore”;

»» “Menaxhimi i Mbetjeve”

»» “Trashëgimia kulturore dhe aktivitetet artistike”

»» “Strehimi Social”

në buxhetin me ndryshime rezultojnë të pabuxhetuara. Buxheti i parashikuar në fillim të vitit për këto zëra rezulton i rialokuar në programe të tjera. Në dokumentat zyrtarë të publikuar nga Bashkia Kukës nuk gjejmë informacion mbi rishpërndarjen buxhetore mes programeve dhe cila ka qenë arsyeja e këtyre ndryshimeve. Rishpërndarja e fondeve mes programeve buxhetore, referuar legjislacionit në fuqi, duhet të realizohet me një vendim të këshillit bashkiak të shoqëruar dhe me argumentat përkatës të realizimit të tij.

## 5.2.1 Performanca e shpenzimeve për programet buxhetore

Referuar performancës së shpenzimeve për çdo program buxhetor, duke bërë një renditje sipas përqindjes së realizimit të fondeve, konstatojmë se:

a) Vetëm 2 nga 14 programe buxhetore shfaqin një performancë normale të shpenzimeve të periudhës, e konkretisht programi “Gjendja Civile” me realizim të shpenzimeve në masën 45% dhe programi “Shërbimet Pyjore” me performancë 42%.

b) Performancë të shpenzimeve mbi mesataren normale për 6-mujorin prej 50% shfaqin programet “Sporti”, “Shërbimet komunitare” dhe “Përkujdesi Social”, që shkojnë respektivisht në nivelin prej 86%, 71% dhe 66%. Në mungesë të analizave përkatëse të bëra në të dhënat zyrtare, ky nivel realizimi dëshmon për një planifikim të dobët të buxhetit të bërë nga Bashkia Kukës, gjë që do të sjellë nevojën për rishpërndarje buxhetore gjatë vitit 2024 për të plotësuar nevojat e këtyre 3 programeve. Referuar të dhënave që disponojmë vlerësojmë se:

■ Në programin “Sporti”, rezulton se buxheti i planifikuar është rishikuar në ulje, nga 5.6 milionë lekë të planifikuara në fillim të 2024, në 3.5 milionë lekë me buxhetin e rishikuar. Realizimi faktik i programit rezulton në nivelin më të lartë nga të gjitha programet e tjera buxhetore me rreth 86%. Nga analiza e dokumentit të PBA 2024-2026 të Bashkisë Kukës nuk arrijmë të identifikojmë produkte konkrete apo aktivitete sportive të planifikuara për t’u realizuar nga ky program.

■ Në programin “Shërbimet Komunitare” performanca është e lartë si në shpenzimet operative edhe në ato kapitale, dhe sërish mbetet e vështirë të analizohet se cilat janë produktet konkrete të lidhura me të. Ndërkohë, performanca e lartë në shpenzimet administrative dhe operative nevojitet të analizohet me kujdes, pasi rezulton se planifikimi i fondeve do të jetë i pamjaftueshëm për të përmbushur aktivitetin e programit deri në fund të vitit buxhetor.


■ Performanca e lartë në programin e “Kujdesit Social” lidhet me pagesat e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, të cilat përbëjnë një funksion të deleguar për Bashkinë Kukës nga Buxheti Qendror. Rritja e shpenzimet në këtë drejtim mund të ketë 2 shkaqe: (i) keqplanifikimin ose (ii) është rritur numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë. Këto shkaqe janë supozime të bëra nga ana jonë pasi të dhënat zyrtare janë të pamjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të qarta.

■ Ndërkohë që, të gjitha programet e tjera buxhetore kanë një performancë financiare të dobët për 6-mujorin, duke shpenzuar mesatarisht rreth 32% të fondeve. Shkaqet e kësaj performancë të dobët nuk mund të analizohen në mungesë të informacioneve të publikuara për të kuptuar më shumë.

■ Nëse do t'i referohemi performancës sipas grup-artikujve kryesorë të shpenzimeve, më poshtë paraqitet një tablo e situatës 6-mujore për Bashkinë Kukës:

Figura 1: Performanca e shpenzimeve sipas zërave kryesorë për 6 mujorin e parë 2024

### PËRQINDJA E REALIZIMIT TË BUXHETIT SIPAS GRUP ARTIKUJVE PËR 6 MUJORIN E PARË 2024



## 5.2.2 Niveli i realizimit të projekteve të investimeve publike

Nëse do të ndalemi në analizën e projekteve të investimeve publike, më poshtë po raportojmë realizimin faktik të tyre sipas programeve buxhetore:

Tabela 7 Plani dhe Fakti i shpenzimeve për projektet e investimeve publike


Programi	Projekti	Plan	Fakt	% e realizimit
Administrata	Ndertim i rrjetit KUZ Lagjia Drinas, Kukes	1 329 604	0	0%
Emergjencat Civile	Rikonstruksion i sherbimit zjarrfikes dhe sheshit	264 344	0	0%
Sherbimi Pyjor	Investim per pyllezimin e ekonomike pyjore	1 926 364	1 926 364	100%
Administrata	Studim projektim per rehabilitimin e lagjeve nr.4.5.6	1 500 000	1 500 000	100%
Administrata	Hartim projektesh per investime prioritare	19 240 000	0	0%
Administrata	Ndertimi i banesave sociale	137 286	0	0%
Ujitja dhe Kullimi	rehabilitimi i kanalit ujitjes Shkinak-lezhe, Bushtrice	1 223 130	0	0%
Sherbimi Pyjor	Investim per pyllezimin e ekonomike pyjore	3 332 403	3 332 403	100%
Sherbime Komunitare	hartim projektim i rikualifikimit te lagjeve nr.1,2,3 Kukes	11 880 000	6 000 000	51%
Sherbime Komunitare	restaurimi i lapidarit dhe varrezave te deshmoreve	33 000	0	0%
Sherbime Komunitare	rehabilitimi i rruges per tek varrezat e deshmoreve	27 000	0	0%
Sherbime Komunitare	Asfaltim i rruges se fshatit Bushat	116 653	0	0%
Sherbime Komunitare	Rikonstruksion i rruges Malqene	53 824	0	0%
Sherbime Komunitare	Ndertim i bazementit te fushes stervitore	124 025	0	0%
Sherbime Komunitare	Sistem asfaltim fshati nange	7 253 793	7 214 193	99%
Sherbime Komunitare	ndertim i rruges Kolsh	28 980	0	0%
Sherbime Komunitare	Ndertim i rruges Qender Shtiqen Aeroport	19 048 891	18 996 091	100%
Sherbime Komunitare	Rikonstruksion i sherbimit zjarrfikes dhe sheshit	33 600	0	0%
Sherbime Komunitare	Rikonstruksioni i lagjes Gostil lot 1	19 201 373	18 875 988	98%
Sherbime Komunitare	Asfaltim i rruges Kalimash	7 960 762	7 931 962	100%
Sherbime Komunitare	Mobilim i zyrave te MZSH	690 000	0	0%
Sherbime Komunitare	Mobilim pajisje per qendren e moshave te treta	1 021 200	1 021 200	100%

Sherbime Komunitare	Fatkeqesi natyrore te menaxhuara	233 734	0	0%
Arsimi Parashkollor	Rikonstruksion kopshti lagjia nr.1 Kukes	1 610 240	85 080	5%
Arsimi Parashkollor	Rehabilitim I shkolles fshati Bicaj	5 065 580	0	0%
Konvikti dhe Arsim I Mesem	Rikonstruksion I shkolles Havzi Nela	882 248	827 956	94%
Projekte UKK	Optimizimi I furnizimit me uje te qytetit Kukes	18 569 772	0	0%
Projekte UKK	Supervizion punimesh per projektin optimizimi I furnizimi me uje te qytetit Kukes	1 637 588	0	0%
Arsimi Parashkollor	Rehabilitim I shkolles fshati Bicaj	24 118 547	0	0%
Arsimi Parashkollor	Rikonstruksioni I kopshtit nr.3, lagjia nr.5, Bashkia Kukes	17 000 000	0	0%
Arsimi Parashkollor	Pajisje Mobileri arsimi B.Kukes	6 768 812	0	0%
Konvikti dhe Arsim I Mesem	Rehabilitim I shkolles Avni Rustemi Kukes	33 000 000	0	0%
Konvikti dhe Arsim I Mesem	Pajisje Mobileri arsimi B.Kukes	3 647 985	0	0%
Emergjencat Civile Qendrori	Fatkeqesi natyrore te menaxhuara	2 418 565	0	0%
	TOTALI	211 775 303	68 107 237	32%

Buxheti i miratuar për vitin 2024 për projektet e investimeve publike për Bashkinë Kukës është 157.6 milionë lekë. Ndërkohë, referuar të dhënave zyrtare të buxhetit me ndryshime, rezulton se fondi total i planifikuar për investime publike për Bashkinë Kukës është 211.7 milionë lekë, ose rreth 55 milionë lekë më shumë.

Kjo diferencë ndërmjet shifrave plan të buxhetit shpjegohet nga fakti që në raportimin e investimeve publike të Bashkisë Kukës përfshihen dhe fondet që investohen nga Buxheti Qendror për llogari të Bashkisë, por nga të dhënat zyrtare nuk arrihet të identifikohen qartë se cilat projekte financohen nga të ardhurat e bashkisë dhe cilat nga buxheti qendror.

Grafiku 1: Shpërndarja e investimeve publike sipas programeve buxhetore



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e fondeve buxhetore në projekte të investimeve publike sipas programeve buxhetore vihet re që 32% e fondeve shkojnë për programin “Shërbime Komunitare”, ku përfshihen kryesisht rehabilitimet e rrugëve rurale dhe lagjeve të qytetit. 26% e fondeve të investimeve publike planifikohen të përdoren për programin “Arsimi parashkollor” dhe 18% e fondeve shkojnë për programin “Arsimi i Mesëm”. Shërbimit Pyjor, Ujitjes dhe Kullimit i dedikohen shumë pak fonde për investime publike, vetëm 1-2% të totalit, pavarësisht se objektivat strategjikë të Bashkisë Kukës kanë në fokus ekonominë bujqësore dhe pyjore si përparësi e zonës tek e cila duhet investuar.

Investimet publike janë realizuar për 6-mujorin e parë të vitit në nivelin 68.1 milionë lekë ose rreth 32% ndaj totalit të planit.

## 5.2.3 Performanca e projekteve

### 5.2.3.1 Performanca financiare

Nga një krahasim i projekteve të planifikuara në dokumentin e Buxhetit për vitin 2024 me ato të financuara realisht, konstatojmë devijanca nga plani të cilat lidhen kryesisht me projektet e programit “Shërbime Komunitare”. Lista e projekteve rezulton e shtuar në numër krahasuar me ato të miratuara në Dokumentin e Buxhetit të vitit 2024.

Lidhur me performancën financiare të projekteve të investimeve publike vërejmë se nga 35 projekte investimesh të planifikuara për t’u realizuar kanë pasur progres 12 projekte. Konkretisht sipas funksioneve kryesore janë realizuar me sukses këto projekte:

- ✓ Për programin e Shërbimit Pyjor është realizuar projekti “Investim për pyllëzimin e ekonomisë pyjore”;
- ✓ Për programin “Administrata” është realizuar projekti “Studim projektim për rehabilitimin e lagjeve nr.4.5.6”;
- ✓ Për programin “Arsimi Parashkollor” kanë filluar punimet për projektin “Rikonstruksion kopshti lagjia nr.1 Kukës”. Projekti është planifikuar të kushtojë 1.6 milionë lekë dhe deri në fund të 6 mujorit të parë janë shpenzuar vetëm 5% e fondeve.
- ✓ Për programin “Konvikti dhe Arsimi i Mesëm” ka përfunduar rikualifikimi i shkollës së mesme “Havzi Nela”, me një vlerë të kontratës për vitin 2024 prej 882 mijë lekë.
- ✓ Për programin “Shërbime Komunitare” janë realizuar me sukses 7 nga 16 projekte të planifikuara në këtë program ku përmendim:
- ✓ Ndërtimi i rrugës Qendër-Shtiçen-Aeroport me një vlerë prej 18.9 milionë lekë nga 19 milionë lekë të planifikuar në buxhet;

- ✓ Rikonstruksioni i lagjes Gostil lot 1 me një vlerë 18.9 milionë lekë nga 19.2 milionë lekë të planifikuar në buxhet;
- ✓ Sistem asfaltim fshati Nange;
- ✓ Rehabilitim dhe mobilim i qendrës së të moshuarëve me një vlerë të planifikuar dhe realizuar plotësisht prej 1.6 milionë lekë;

## 5.2.3.2 Performanca jo-financiare

Pavarësisht se projektet rezultojnë të realizuar me performancë të lartë financiare, në terma të performancës jo-financiare nuk gjejmë në dokumentat zyrtarë se si pritet ose kanë ndikuar pozitivisht këto projekte në përmbushjen e objektivave të Bashkisë Kukës për vitin 2024 dhe, po ashtu, se si kanë ndikuar në jetën e qytetatërve të kësaj Bashkie këto projekte investimesh.

Produktet dhe treguesit e tjerë të performancës të cilat sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe vetëqeverisjes vendore duhet të jenë pjesë e dokumentave të raportimit të Bashkisë në procesin e monitorimit të buxhetit, mungojnë tërësisht ose dhe në rastet e pakta ku ato paraqiten në mënyrë sporadike në disa programe buxhetore nuk plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të tilla. Shumica e produkteve të formuluar nga Bashkia Kukës përfaqësojnë aktivitete ose shpenzime ekonomike dhe jo produkte të mirëfillta të punës së Bashkisë.

Si rezultat është e pamundur të analizosh për performancë jo-financiare të 6-mujorit të parë në terma produktesh dhe treguesish performance.

*Në përfundim vlerësojmë që informacioni zyrtar i publikuar nga Bashkia Kukës për pjesën e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2024 rezulton i kufizuar, me cilësi të dobët dhe analiza bazike financiare. Raportet e publikuara të lidhura me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm, Buxhetin dhe Monitorimin 4-mujor të tij rezultojnë ushtrime teorike e pa përmbajtje thelbësore, duke ndikuar në nivelin e transparencës në tërësi sa i përket procesit të buxhetimit të ndjekur nga Bashkia Kukës në të gjitha hallkat e tij.*

## 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Gjetjet kryesore të raportit të monitorimit:

- Të ardhurat e Bashkisë Kukës rezultojnë të kufizuara me mesatarisht 9%, ndaj totalit të buxhetit të Bashkisë ndërkohë që varësia nga buxheti qendror rezulton jetike për të mundësuar që të përmbushen funksionet bazë dhe ato të deleguara të pushteti qendror. Sipas raportit të fundit të situatës financiare të vitit 2023, të publikuar nga Ministria e Financave, Bashkia Kukës renditet ndër Bashkitë me rënien më të madhe të ardhurave. Në këtë raport, si dhe në dokumentat buxhetor të Bashkisë Kukës mungojnë analizat mbi shkaqet e kësaj performance dhe masat e marra për përmirësimin e saj.
- Cilësia e planifikimit buxhetor afatmesëm të Bashkisë Kukës rezulton e dobët dhe jo në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore të fushës së menaxhimit të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Kjo cilësi e dobët përkthehet në mungesë informacioni dhe transparence për qytetarët e Bashkisë Kukës mbi eficientësinë dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike në drejtim të adresimit të nevojave dhe prioriteteve të zonës.
- Nga një vështrim i hollësishëm i dokumentit të PBA të Bashkisë dhe dokumentit të Buxhetit 2024 mbi investimet publike kuptohet se përveç emrit të projektit është e vështirë të analizosh se si është bërë prioritarizimi i tyre dhe për pasojë zgjedhja për financim për vitin në fjalë. Mungojnë informacione në terma përfituesish dhe analiza cilësore për të lidhur nevojat e shprehura në takimet konsultative të buxhetit të qytetarëve të bashkisë Kukës me adresimin e tyre konkret në buxhet.
- Referuar performancës së shpenzimeve, 9 nga 14 programe buxhetore kanë një performancë financiare të dobët për 6-mujorin, duke shpenzuar mesatarisht rreth 32% të fondeve. Shkaqet e kësaj performance të dobët nuk mund të analizohen në mungesë të informacioneve të publikuara për të kuptuar më shumë.
- 3 nga 14 programet buxhetore kanë një performancë mbi normalen për periudhën, duke ngritur alarmin për pamjaftueshmëri fondesh për të realizuar funksionet e tyre në 6-mujorin e dytë të vitit 2024.

■ Investimet publike janë realizuar vetëm 32% gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 dhe pjesa më e madhe është shpërndarë për programet “Shërbime Komunitare”, “Arsimi Parashkollor” dhe “Konviktet dhe Arsimi i Mesëm”, duke lënë të paadresuara nevojat e qytetarëve të lidhura me funksionet parësore të qytetit sikurse është bujqësia dhe pyjet.

■ Disa nga projektet e investimeve rezultojnë të realizuar me performancë të lartë financiare për periudhën 6-mujore, megjithatë në terma të performancës jo financiare nuk gjejmë në dokumentat zyrtarë se si pritet ose si kanë ndikuar pozitivisht këto projekte në përmbushjen e objektivave të Bashkisë Kukës për vitin 2024. Po ashtu nuk ka informacion se si kanë ndikuar në jetën e qytetarëve të kësaj Bashkie këto projekte investimesh.

■ Produktet dhe treguesit e tjerë të performancës të cilat, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe vetëqeverisjes vendore, duhet të jenë pjesë e dokumentave të raportimit të Bashkisë në procesin e monitorimit të buxhetit, paraqiten në mënyrë sporadike në disa programe buxhetore ose mungojnë tërësisht në raste të tjera.

## **Nisur nga gjetjet e sipërcituara rekomandojmë për Bashkinë Kukës:**

■ Përmirësimin e cilësisë së dokumentave buxhetorë në të gjithë ciklin e menaxhimit të buxhetit, duke respektuar në tërësi metodologjinë e përgatitjes së buxhetit dhe raporteve të zbatimit dhe monitorimit të tij;

■ Rritje e transparencës dhe llogaridhënies për qytetarët në drejtim të prezantimit të rezultateve të arritura nga produktet dhe projektet e buxhetit për vitin 2024 e në vazhdim, duke mos u mjaftuar me organizimin e dëgjesave publike në kuadër të përgatitjes së buxhetit, por dhe në kuadër të monitorimit të tij gjatë vitit. Qytetarët nevojiten të informohen për procesin e zbatimit të buxhetit dhe rezultatet e arritura për zonën, duke prezantuar informacionin në terma përfituesish dhe arritjesh konkrete;

■ Rritjen e transparencës sa i përket procesit të përzgjedhjes dhe prioritarizimit të investimeve publike për Bashkinë Kukës, për ta bërë më të qartë mënyrën e përzgjedhjes së projekteve dhe cilat janë burimet e financimit të tyre (qendror vs vendor);

■ Hartimin e politikave dhe planeve të masave respektive për të rritur të ardhurat e veta të bashkisë, duke u fokusuar në fushat më problematike të saj.

## REFERENCA

- 1.Financat Publike Vendore. Raporti 2023. Ministria e Financave 2024. I disponueshëm: <https://core.fvv.al/storage/reports/analiza-e-financave-vendore-2023-finalpdf-1721811582.pdf>
- 2.Ligji nr.9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. I disponueshëm: <https://financa.gov.al/buxheti-6/>
- 3.Ligji nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. I disponueshëm: <https://financa.gov.al/financat-vendore-2/>
- 4.Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. I disponueshëm: <https://financa.gov.al/financat-vendore-2/>
- 5.Raporti vjetor i financave vendore për vitin 2023. I disponueshëm: <https://www.fvv.al/reports>
- 6.Shkresa e Bashkisë Kukës nr.3222/1,prot, datë 8.7.2024 “Kthim përgjigje shkresës nr.5/2024, datë 1.7.2024 “Kërkesë për informacion rreth ecurisë së zbatimit të buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës”.
- 7.Udhëzim standard për përgatitjen e buxhetit vendor. I disponueshëm: <https://financa.gov.al/udhezim-standard-per-pergatitjen-e-pba-se-vendor>
- 8.Udhëzim standard për monitorimin e buxhetit vendor. I disponueshëm: <https://financa.gov.al/udhezim-standard-per-monitorimin-e-buxhetit-vendor/>
- 9.Vendimi nr.46, datë 5.07.2024 i Këshillit Bashkiak Kukës “Për miratimin e raportit periodik 4-mujor të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Prill 2024”. I disponueshëm: <https://kukesi.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-periodik-Janar-Prill-2024.pdf>
- 10.Vendimi nr.65, datë 22.12.2023 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 për Bashkinë Kukës. I disponueshëm: <https://kukesi.gov.al/ep-content/uploads/2024/01/Buxheti-2024.pdf>
- 11.Vendimi nr.66, datë 22.12.2023 “Për miratimin e PBA 2024-2026”. I disponueshëm: <https://kukesi.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Relacioni-final-PBA-2024-2026.pdf>